

## THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

**“Për shërbimin e konsulencës për përmirësimin e cilësisë, etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, me fokus të veçantë grupet cënueshme dhe viktimat e trafikimit”.**

<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë, SHQIPËRI
<b>Afati i aplikimit:</b>	20-maj-2024 (16.00)
<b>Tipi i kontratës:</b>	Kontratë shërbimi
<b>Gjuha e kërkuar:</b>	Shqip & English
<b>Koha e shërbimit:</b>	25 ditë
<b>Ref no.</b>	25.04.24.1

Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (NASRI) mbështetur në Marrëveshjen e Partneritetit me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), fton organizatat ose individët (grup individesh) të interesuar për të shprehur interesin mbi:

**Përmirësimin e procedurave të aplikimit për projekte të kërkimit dhe ngritjen e kapaciteteve të kërkuesëve shkencore me qëllim përmirësimin e cilësisë, etikës dhe integritetit në kërkim me fokus të veçantë grupet e cënueshme dhe viktimat e trafikimit”**

Shërbimi i konsulencës (“Shërbimi”) do të fokusohet në:

1. Rishikimin e procedurave të aplikimit, vlerësimit miratimit dhe monitorimit të menaxhuara nga AKKSHI sipas programeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Mbështetjen e institucioneve akademike për shkrimin e projekt propozimeve për kërkime mbi analizën dhe studimin e grupeve të cënueshme dhe viktimave të trafikimit;
3. Të mbështesë stafin e AKKSHI për adresimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian për çështje të shkencës së hapur dhe procesit të analizës së kapitullit 25 “Shkenca dhe kërkimi”;
4. Organizimin e seminareve ku të diskutohen dhe validohen çështjet e mësipërme me aktorët e interesuar dhe komunitetin e kërkuesëve shkencorë në IAL.

Sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë të përcaktuar në kuadrin ligjor të krijimit, organizimit dhe funksionimit të saj (përcaktuar në VKM 607 date 31.08.2026), synon të kontraktojë një ekspertizë të jashtme afatshkurtër për ofrimin e shërbimeve të mësipërme, me qëllim lehtësimin e kërkuesëve shkencorë në realizimin e aktiviteteve kërkimore cilësore, në përputhje me parimet e etikës dhe integritetit.

### **Procedura e aplikimit:**

AKKSHI fton organizatat, individët, ose grup individesh të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e “Shërbimit”.

### **ÇFARË DUHET DORËZUAR NË PAKETEN E SHPREHJES SE INTERESIT**

Aplikantët duhet të dorëzojnë në AKKSHI për shqyrtim dokumentet e kërkuara të mëposhtme.

1. Letër motivimi në shqip dhe anglisht ku të shpjegojnë ndër të tjera, vizionin e tyre për këtë ekspertizë si dhe eksperiencat e mëparshme

2. Një metodologji të shkurtër të organizimit të punës për të arritur afatet e realizimit të detyrës;
3. Numrin dhe CV e ekspertëve që do të angazhohen në kryerjen e shërbimeve të mësipërme, duke specifikuar detyrat që do të realizojë secili prej tyre.
4. Ofertën financiare indikative
5. Kopje e përditësuar e NIPT-it;
6. Ekstrakt i lëshuar nga NCB (QKB), nëse është e aplikueshme;
7. Regjistrimi i organizatës/institucionit në gjykatë, (nëse ka);
8. Ekstrakti më i fundit nga regjistri i OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (nëse ka);
9. Vërtetim se subjekti nuk ka asnjë çështje të hapur të regjistruar, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, (kur është e aplikueshme).

Datat e sakta për fillimin dhe përfundimin e kontratës do të negociohen me dhënien e kontratës. Organizata ose individët e kontraktuar do të zhvillojnë aktivitete sipas seksionit të mësipërm të aktiviteteve/produkteve, në bashkëpunim të ngushtë me AKKSHI-në

Periudha tentative e fillimit të punës: 25 maj 2024

Për pyetje dhe më shumë detaje kontaktoni [info@nasri.gov.al](mailto:info@nasri.gov.al) deri në datë 13 maj 2024.

Bashkëngjitur kesaj thirrje gjëni TOR.

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **20 maj 2024**, ora 16.00, në adresën: Agjencia Kombëtare për kërkimin shkencor dhe inovacionin, Adresa: Rruga "Naim Frasheri", Nr.37, Tiranë, Shqipëri, ose me E-mail: [info@nasri.gov.al](mailto:info@nasri.gov.al);

Vetëm kandidati/ët e përzgjedhur do të kontaktohen për procedurë të mëtejshme.